



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 02/05

Datë: 15.06.2020

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të nenit 15 paragrafi 4 të Ligjit Nr. 04/L-036 për Statistikat Zyrtare të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe i plotësuar me Ligjin Nr. 06/L-058, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores Nr. 06/2020 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, në pajtim me nenin 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 15 qershor 2020, merr këtë:

V E N D I M

1. Aprovohet Plani Vjetor i Statistikave Zyrtare për vitin 2021.
2. Agjencia e Statistikave të Kosovës është e obliguar që pjesën e implikimeve financiare të këtij Plani ta harmonizojë me Ligjin për Buxhetin e vitit 2021.
3. Obligohet Agjencia e Statistikave e Kosovës për zbatimin e Planit nga pika 1. e këtij vendimi në pajtim me Rregulloren e Punës së Qeverisë.
4. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Avdullah HOTI

Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë